



OSHEE GROUP njofton mbi hapjen e vendit vakant **Lexues** pranë OSSH / Drejtoria Rajonale Shkodër / Grupi Operativ 4 Shkodër 1 / Ekipi 1 NSt. Shkodër 1.

LEXUES

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen leximin e rregullt të konsumatorëve dhe foto të matjes duke respektuar grafikun e leximit të miratuar më parë.
- Regjistron leximet në kompjuterin personal portativ (PDA) dhe i ngarkon ato sistemin qendror të të dhënave.
- Angazhohet maksimalisht për të realizuar leximin e matësit duke koordinuar orar tjetër në raste se objekti rezulton i pa-aksesueshëm sipas grafikut.
- Identifikon dhe raporton nëpërmjet PDA, në programin e leximit mobiread, anomalitë e konstatuara gjatë procesit të leximit dhe është përgjegjës për cilësinë/saktësinë e të dhënave.
- Verifikon leximet në rast kur konsumi duket që ka ndryshime të mëdha nga të mëparshmet.
- Inspekton matësat për lidhje të pa-autorizuara, difekte dhe dëmtime (edhe të elementeve të sigurisë) dhe raporton ato eprorit të drejtpërdrejtë.
- Kryen rilexime të konsumatorëve brenda muajit sa herë që kërkohen.
- Raporton tek eprori i drejtpërdrejtë rastet problematike gjatë procesit të leximit të pa përfshira ne kodet e anomalive.
- Merr pjesë në ndërprejen e energjisë për konsumatorët debitore dhe ri-lidhjen në rast shlyerje të detyrimeve.
- Monitoron funksionimin PDA dhe siguron përdorimin në mënyrën e duhur të saj. Raporton difekte dhe problematika të punonjësit e ngarkuar për mirëmbajtjen.
- Është bashkpërgjegjës për humbjet në rrjet.
- Mirëmban dhe përditëson të dhënat mbi adresën e konsumatorëve pjesë të grafikut që mbulon së bashku me të dhënat mbi vendndodhjen e matësit.
- I jep përgjigje pyetjeve të konsumatorëve mbi shërbimet, tarifat ose i orienton ata të kontaktojnë Kujdesin Ndaj Klientit duke demonstruar një qëndrim që klientet janë gjithmonë të parët.
- Aktivitete të tjera dhe detyra të ngarkuara nga eprori i drejtpërdrejtë.



Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të zotërojë Diplomë të arsimit të Mesëm.
- Të ketë aftësi shumë të mira të etikës dhe komunikimit.
- Të kryej detyrat e ngarkuara me përgjegjësi.
- Të ketë aftësi për të punuar në grup.

Dokumentat për dorëzim:

- Curriculum Vitae (CV)
- Letër Interesi – në të cilën duhet të specifikohen arsyet të cilat ju mendojnë se ju bëjnë një kandidat potencial për këtë pozicion;